



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eco.logic" L.L.C të datës 01.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i thertores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-23-141-511, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eco.logic" L.L.C e datës 01.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i thertores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-23-141-511.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Eco.logic" L.L.C si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Eco.logic" L.L.C (tutje "parashtruesi") me datë 01.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i thertores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-23-141-511.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Njoftimi për kontratë është publikuar më datë 10.07.2023, kurse hapja e ofertave është parashikuar të bëhet më datë 08.09.2023. Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përkatësisht tek neni 9.1 dhe 9.2, pika 2 është kërkuar: Specialist i mjedisit i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi, duhet të ketë të paktën një diplomë Bachelor me një minimum prej pesë vite përvojë në një natyrë të ngjajshme, si dhe në pjesën tjetër të dosjes së tenderit është kërkuar Inxhinier i mjedisit 1-ose bachelor-i certifikuar për Siguri dhe shëndet në punë. Kur analizohen të dy kërkesat e lartëcekura kuptohet se këto janë pothuajse të njëjta dhe të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit. Kërkesat e tilla të dyfishuara nuk janë në harmoni me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 27, 69 të LPP si dhe nenin 17 dhe 25 të RRPP.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 08.09.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit fillimisht duhet cekur se kërkesat e dosjes së tenderit për të cilat bëhet fjalë janë evidentuar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: <ul style="list-style-type: none"> • Specialist i mjedisit 1, i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi, duhet te kete te pakten nje diplomë bachelor me min pesë vjet përvojë ne nje natyrë të ngjashme, • Inxhinier i mjedisit 1-ose bachelor - i certifikuar per Siguri dhe shëndet në punë. 	Dëshmia e kërkuar dokumentare: <p>2.Dëshmit e kerkuara; Operatori Ekonomik, duhet të ofroj dëshmi CV-ja, diploma, Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. (Për stafin që nuk gjendet në marrëdhënie pune të ofrohet kontratë për angazhim në emër të projektit, kontrata duhet të jetë e noterizuar në mes të Inxhinierit dhe Punëdhënësit)</p>
---	-----------	---	--

Duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit me datë 01.09.2023 ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 04.09.2023 njësia kërkuese ka kthyer përgjigjen si në vijim: "Operatori ekonomik në kërkesën e tij i referohet pozicioneve te neni 9.1 dhe 9.2 pika 2 mirëpo sa na përket neve si njësi e kërkesës është relevante që personi/at e angazhuar të kenë përgatitjen profesionale dhe certifikimin e nevojshëm për shkak të specificitetit të projektit që i bie që mund të jetë edhe një person që i plotëson standardet e kërkuara apo më shumë". Tutje me datë 04.09.2023 sektori i prokurimit ka dërguar te njësia kërkuese edhe një pyetje shtesë lidhur me pretendimet ankimore të parashtruar si në vijim: "Duke marrë parasysh pretendimin kryesor ankimor të cituar si më sipër si dhe kërkesat e dosjes së tenderit për të cilat bëhet fjalë, kërkojmë nga ju si njësi kërkuese që të ofroni sqarimin e juaj në pyetjet si në vijim: 1. Në këtë rast a bëhet fjalë për profile të njëjta apo të ndryshme të punonjëse (nëse janë profile të ndryshme ku qëndron dallimi mes tyre)? 2. Për juve si njësi kërkuese a janë të domosdoshme të dy këto kërkesa për dosjen e tenderit?". Ndërsa me datë 06.09.2023 njësia kërkuese ka kthyer përgjigjen si në vijim: "me emaili-n e derguar nga ju e

qe ka te bej me pretendimet e pales ankuese Eco Logic japim sqarimin si me posht: Kemi te bejme me dy profile te ndryshme, pra nje(1) inxhinier i Ndertimit I cili ka pune baze, punen e ndertimit dhe nje(1) inxhinier te Mjedisit I cili monitoron komplet punet.. megjithat duke pas parasysh qe punet e ndertimit mund te kene ndikim me te madh ne mjedis, kemi kerkuar qe edhe inxhinieri I Ndertimit te jet I trajnuar per mjedis. Inxhinieri I mjedisit parashihet te mirret me te gjitha punet me fokus mjedisin, pra edhe te profileve tjera. Pra, per neve si njesi kerkuese kemi te bejm me profile te ndryshme .Ne si njesi e kerkeses kemi konsideruar se stafi professional I profileve perkatese ka nje rendesi shume te madhe per realizimin me sukses te ketij projekti. Te mos harrojm se te ndertimi I territoreve duhet te jemi te kujdeshem pasi qe kemi te bejm me sigurin e ushqimit per shkak te ndryshimit te temperatures ne hapësira te ndryshme dhe ndikimi ne mjedis qe mund te kete ndertimi I therrtores, apo therrtorja(mbetjet nga kafshet)”.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të njësisë kërkuese pasi që sqarimet e tilla janë të plota, të bazuara në LPP dhe RRPP, të mbështetura në dëshmitë dhe dokumentet relevante të aktivitetit të prokurimit.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.09.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.